KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 43/2026
Hagë, 26/11/2026

Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, Jakup Krasniqi u kthye në Hagë të shtunën më 21 nëntor 2026, pas vizitës në Kosovë që iu miratua nga Trupi Gjykues bazuar në arsye humanitare bindëse.

Vizitat humanitare mund të miratohen në bazë të rregullës 56 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të DHSK-së, e cila u miratua nga gjykatësit dhe bazohet të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Rregullat Standarde Bazë të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve.

Këto vizita nuk parashihen si e drejtë absolute sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por gjykatësit vendosin mbi kërkesa të tilla në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe i trajtojnë ato me urgjencën dhe dhembshurinë që kërkohet në këto situata.

Kjo ishte vizita e pesëmbëdhjetë e tillë nga një i paraburgosur në Kosovë e urdhëruar nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara për arsye humanitare dhe e organizuar nga gjykata.

Në të njëjtën çështje, më 24 nëntor 2026, Trupi Gjykues urdhëroi të bëheshin publike versionet me më pak redaktime të transkripteve që lidheshin me dëshmitë e 9 dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria në gjykim. Ky urdhër ishte në vijim të vendimeve të mëparshme të Trupit Gjykues për të bërë publike dëshmitë e 67 dëshmitarëve që më parë kishin qenë konfidenciale.

Këto vendime pasqyrojnë karakterin publik të procesit dhe përkushtimin e gjykatësve për transparencë. Gjatë gjykimit për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, shumica e dëshmitarëve dëshmuan tërësisht ose kryesisht në seanca publike, ndërsa 61 dëshmitarë dhanë dëshmi pa masa mbrojtëse.

Dëshmitë e dëshmitarëve që fillimisht ishin konfidenciale rishikohen me qëllim që sa më shumë prej tyre të bëhen publike më vonë, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen në vijimësi të viktimave dhe dëshmitarëve. Transkriptet dhe videoincizimet e seancave gjyqësore publike mund të gjenden në faqen e internetit të DHSK-ë, ku janë të organizuara sipas datës së seancës, ose në kanalin e Gjykatës në *YouTube*.

Të premten e kaluar DHSK-ja hapi dyert për publikun në kuadër të Javës së Drejtësisë në Hagë, gjatë së cilës u ofrua një vizitë mjediset publike të Gjykatës dhe u bë një prezantim mbi mandatin dhe punën e Dhomave të Specializuara.

P.O. Box 47 | 2501 CA, The Hague | The Netherlands | ëëë.scp-ks.org | T +31 (0)6 249 21 036

Ndiqni përditësimet e DHSK-së në faqen tonë "**Aktuale**", në profilet **Twitter** dhe **Instagram** si dhe në kanalin **Youtube**

Për të marrë pjesë në informimet javore të DHSK-së, ju lutemi kontaktoni në MediaKSC@scp-ks.org. *Për informacione të mëtejshme rreth mbrojtjes së të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shihni në* https://ëëë.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine